

Burimet: deklarata N.E, FDH-19506; KKKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFDUÇK, *Feniksët...* 6, 63,64.

Isa (Hysen) Salihaj

(9.02.1922, shqiptar nga Shushica/Sušica, komuna e Istogut/Istok, punëtor ndërtimtarie, dhjetë fëmijë)

Shaban (Isa) Salihaj

(5.05.1950, shqiptar nga Shushica/Sušica, komuna e Istogut/Istok, punëtor ndërtimtarie, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Milaim (Isa) Salihaj

(6.06.1962, shqiptar nga Shushica/Sušica, komuna e Istogut/Istok, punëtor ndërtimtarie, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Abedin (Isa) Salihaj

(1.04.1970, shqiptar nga Shushica/Sušica, komuna e Istogut/Istok, i pamartuar, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Fatime (Xhemë Tuzi) Salihaj

(20.07.1957, shqiptare nga Shushica/Sušica, komuna e Istogut/Istok, bashkëshortja e Shabanit, katër fëmijë)

Hysen (Shaban) Salihaj

(13.03.1975, shqiptar nga Shushica/Sušica, komuna e Istogut/Istok, bujk, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Arben (Shaban) Salihaj

(15.04.1979, shqiptar nga Shushica/Sušica, komuna e Istogut/Istok, bujk, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Hysni (Shaban) Salihaj

(1.08.1981, shqiptar nga Shushica/Sušica, komuna e Istogut/Istok, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Nazmi (Brahim) Gashi

(6.01.1977, shqiptar nga Vojniku/Voćnjak, komuna e Skënderajt/Srbica, i papunë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Familja Salihaj ishte në shënjestër të policisë serbe nga muaji mars i vitit 1998, kur meshkujt e saj iu bashkuan UÇK-së. Djemtë e Isës: Shabani, Milaimi, Abedini dhe Safedini, si dhe i biri i Shabanit, Hyseni, ishin pjesëtarë të njësitit që vepronte në zonën e *Drenicës/Drenica*.

Më datën 26.08.1998, që të gjithë u kthyen nga pozicionet e UÇK-së në shtëpi. Atyre iu bashkua edhe Nazmiu, nipi i vajzës së Isës, Kumrije, gjithashtu pjesëtar i UÇK-së. Më datën **29.08.1998**, në mëngjes, pjesëtarët e policisë serbe kanë qëlluar mbi shtëpinë e familjes Salihaj [**Shushicë/Sušica**]. Meshkujt u kundërpërgjigjën me zjarr. Në atë çast, Safedini gjendej te kushëriri Avdi Salihaj, në fshat. Gratë dhe fëmijët u fshehën në arën e misrit. Rreth orës 15:30, kur të shtënat pushuan, gratë dolën nga misri dhe para shtëpisë gjetën trupin e pajetë të Hysniut dhe Isën e plagosur. Fatimja, nëna e Hysniut, ka mbetur pranë trupit të të birit, ndërsa gratë e tjera me fëmijë shkuan në shtëpinë e Avdi Salihajt. Rreth orës 16:00, Safedini me kushëririn e tij, Avdiun, erdhi deri te shtëpia e vetë dhe aty i gjeti të vranë Isën dhe Hysniun. Për shkak të frikës nga forcat serbe, trupat e tyre i kanë lënë në oborr. Të nesërmen, bashkëshortja e Isës, Kada, dhe gratë e tjera u kthyen në shtëpi. Në garazhin e kushëririt Fadil Salihajt, afër shtëpisë, i gjetën trupat e Shabanit, Milaimit, Abedinit, Hysenit, Arbenit dhe Nazmiut. Gratë nga familjarët kuptuan se ata i bartën trupat nga oborri. Për Fatimen askush nuk dinte asgjë.

Isa, Shabani, Milaimi, Abedini, Hysni, Hyseni, Arbeni dhe Nazmiu janë varrosur të nesërmen, më 30.08.1998, në varrezat familjare në Shushicë/Sušica. Disa muaj më vonë, familja ka dëgjuar se në pyllin e fshatit Padalishtë/Padalište ekzistonte një varr dhe se askush nuk dinte se kush ishte i varrosur aty. Familja Salihaj në atë varr i ka gjetur mbetjet mortore të Fatimes. Ato u rivarrosën në datën 29.08.1999 në varrezat familjare në fshatin Shushicë/Sušica. Më 7.08.2000, ekspertët ndërkombëtarë e kanë bërë zhvarrosjen e mbetjeve mortore të anëtarëve të familjes Salihaj. Pas obduksionit, familjarët sërish dhe në të njëjtin vend i kanë varrosur mbetjet mortore të anëtarëve të vranë të familjes së vet.

Burimet: deklarata S.S, FDH-16342; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SMIP, *Teroristički...*, III, 484; KKKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SHFDUÇK, *Feniksët...* 9, 8-9,